Njoftim i rendësishëm!

Aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale

1. Kandidati për praktikant përzgjedh IAPP-të nga lista vjetore e publikuar në faqen e

MASh dhe dërgon kërkesën për zhvillimin e praktikës profesionale pranë DAR/ ZAsë përkatëse (sipas shtojcës 5 "Formati i aplikimit", bashkëlidhur kësaj Rregulloreje).

2. Kërkesës i bashkëngjiten këto dokumente:

a. CV e praktikantit;

b. fotokopje e noterizuar e dokumentit të identifikimit;

c. fotokopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare në fushën e edukimit;9

d. fotokopje e noterizuar e listës së notave të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë;

e. raporti mjeko- ligjor;

f. vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;

3. Dokumentacioni (përveç formularit të aplikimit) dorëzohet pranë DAR/ZA-së vetëm në aplikimin e parë dhe shërben edhe për aplikimet pasardhëse, në rast se praktikanti nuk e kryen me sukses praktikën profesionale.

4. Nëse praktikanti riaplikon në një DAR/ZA tjetër, ai tërheq dokumentacionin nga DAR/ZA, në të cilën kishte aplikuar në fillim dhe e dorëzon në DAR/ZA-në tjetër.

Në zbatim të udhëzimit të MASH për zhvillimin e praktikës profesionale ju njoftojmë se afati i regjistrimit është nga data 10/12/2011 deri më 20/12/2011,për të gjithë ata studentë që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve pas datës 12 Janar 2011 dhe kanë fituar diplomë: "Master Profesional"ose "Master Shkencor" dhe aktualisht janë pa punë.

Praktika fillon më date 05/01/2012 dhe përfundon në datën e mbylljes së procesit mësimor.Perveç dokumentave të kërkuara në rregullore praktikantët duhet të paraqesin dhe një vërtetim banimi në rajonin e tyre.